

V E N D I M
Nr. 47, datë 7.7.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 23.6.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.48 Akti që i përket :

K Ë R K U E S A:

1. KËSHILLI I RRETHIT KUKES, i përfaqësuar nga kryetari Shefqet Bruka.

2. BASHKIA KUKES, e përfaqësuar nga zoti Ramiz Lala.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Ministri i Drejtësisë, zoti Ilir Panda.

O B J E K T I :

Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit nr.127, datë 28.3.1999 i Këshillit të Ministrave.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palëve kërkuese, të subjektit të interesuar dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Këshilli i Rrethit dhe Bashkia e Kukësit kanë kërkuar nga kjo Gjykatë shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.127, datë 28.3.1999 “Për disa masa për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova”.

Si argument për papajtueshmërinë me Kushtetutën të këtij akti, kërkuesit kanë parashtruar se vendimi nuk ka dalë në bazë e për zbatim të ndonjë ligji, kërkesë thelbësore për aktet nënligjore, e parashikuar shprehimisht nga neni 118 pika 1 e Kushtetutës.

Gjatë shqyrtimit të çështjes Gjykata Kushtetuese konstatoi para së gjithash, se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.127, datë 28.3.1999 nuk është i botuar në Fletoren Zyrtare. Sipas nenit 117, pika 1 të Kushtetutës “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”. Në referim të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata arrin në përfundim se akti objekt kërkese nuk ka marrë fuqi juridike.

Ndonëse rasti në shqyrtim përbën një praktikë të Këshillit të Ministrave që vjen ndesh me kërkesat e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vendosë për një akt që në bazë të Kushtetutës nuk ka marrë fuqi juridike e për pasojë kërkesa meqënëse i mungon objekti duhet të rrëzohet. Për më tepër, duhet nënvizuar se Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 132 pika 1 të Kushtetutës ka të drejtë vetëm shfuqizimin e akteve që shqyrton, dmth., akteve që kanë marrë fuqi juridike. Përsa i përket ndreqjes së pasojave, kjo nuk hyn në sferën e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk mund të mos verë në dukje edhe një fakt tjetër që ka të

bëjë me moszbatimin e kërkesave të Kushtetutës nga Këshilli i Ministrave, edhe pse ky fakt në rastin konkret nuk ndikon në përfundimin si më sipër të çështjes. Konkretisht, Gjykata ka konstatuar se Këshilli i Ministrave Vendimin nr.127, datë 28.3.1999 nuk e ka nxjerrë në bazë e për zbatim të ndonjë ligji të veçantë, çka përbën shkelje të nenit 118 pika 1 të Kushtetutës.

PER KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a dhe 134/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.7.1999

Nr. 47 i Regjistrimit themeltar.

Nr. 47 i Vendimit.